



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

RAPORT MONITORUES

SIGURIA E GAZETARËVE DHE LIRIA E MEDIAS NË KOSOVË

(Raport monitorues për periudhën janar – maj 2026)

Qershor, 2026

Autore: Albana Hasani

Ekspert i mediave: Abit Hoxha

Ekspert ligjor: Yll Zekaj

Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit "Forcimi i Lirisë së Medias, Bashkëpunimit Ndëretnik dhe Luftimit të Gjuhës së Urrejtjes në Kosovë", i zbatuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës me mbështetjen e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ekskluzivisht të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).

1. METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I RAPORTIT
 2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE
 3. HYRJE
 4. VLERËSIMET MBI LIRINË E MEDIAS NË KOSOVË NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE
 5. RETROSPEKTIVË E SIGURISË SË GAZETARËVE NË KOSOVË (2021 – 2025)
 6. GJENDJA E SIGURISË SË GAZETARËVE NË KOSOVË GJATË PERIUDHËS JANAR – MAJ 2026
 - 6.1 RASTET E RAPORTUARA NË POLICINË E KOSOVËS
 - 6.1 RASTET MË SHQETËSUESE TË EVIDENTUARA GJATË PERIUDHËS JANAR – MAJ 2026 13
 - 6.2 DIMENSIONI GJINOR I RASTEVE TË RAPORTUARA NË POLICINË E KOSOVËS
 7. TRAJTIMI I KALLËZIMEVE PENALE QË NDËRLIDHEN ME GAZETARËT NGA PROKURORITË THEMELORE TË KOSOVËS
 8. MUNGESA E REAGIMEVE PUBLIKE NDAJ SULMEVE KUNDËR GAZETARËVE DHE AKTIVISTËVE
 - 8.1 RETORIKA STIGMATIZUESE NDAJ MEDIAVE
 9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME
-

1. METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Kosovë, me fokus të veçantë në periudhën janar - maj 2026, duke përfshirë gjithashtu edhe analizë retrospektive të zhvillimeve dhe trendeve kryesore gjatë viteve 2021 - 2025.

Në aspekt metodologjik, raporti është hartuar duke përdorur metodën e analizës cilësore dhe sasiore të të dhënave. Metodologjia është bazuar në:

- analizimin e të dhënave statistikore institucionale;
- dokumentimin dhe monitorimin e rasteve të raportuara;
- analizën e raporteve dhe burimeve relevante vendore dhe ndërkombëtare;
- si dhe shqyrtimin e deklaratave publike, reagimeve institucionale dhe raportimeve mediale që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias në Kosovë.

Raporti mbështetet kryesisht në të dhënat statistikore zyrtare të siguruara nga Policia e Kosovës (PK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), lidhur me rastet e sulmeve, kërcënimeve dhe incidenteve që ndërlidhen me gazetarët dhe punonjësit e mediave. Gjithashtu, raporti përfshin edhe rastet e dokumentuara nga vetë Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), përfshirë rastet e raportuara publikisht nga vetë gazetarët, mediat dhe organizatat monitoruese.

Për nevoja të raportit, AGK ka kërkuar informacione edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), mirëpo sipas përgjigjes së pranuar, KGJK nuk posedon statistika specifike lidhur me rastet që ndërlidhen me gazetarët dhe punonjësit e mediave. Mungesa e statistikave të strukturuar nga sistemi gjyqësor paraqet kufizim metodologjik në vlerësimin e plotë të trajtimit gjyqësor të rasteve që prekin sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias.

Raporti bazohet kryesisht në rastet e raportuara institucionalisht dhe ato të dokumentuara nga AGK. Megjithatë, duke marrë parasysh fenomenin e mos-raportimit, veçanërisht në rastet e kërcënimeve verbale dhe sulmeve online, ekziston mundësia që numri real i incidenteve ndaj gazetarëve dhe punonjësve medialë të jetë më i lartë sesa rastet e evidentuara në këtë raport. Përveç funksionit dokumentues dhe monitorues, raporti synon të shërbejë edhe si instrument avokimi për forcimin e mbrojtjes institucionale të gazetarëve, avancimin e lirisë së medias dhe krijimin e një ambienti më të sigurt për ushtrimin e profesionit të gazetarisë në Kosovë.

2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet një analizë të gjendjes së sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Kosovë gjatë periudhës janar - maj 2026, duke përfshirë gjithashtu një pasqyrë të zhvillimeve, trendeve dhe sfidave kryesore që kanë karakterizuar lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve gjatë periudhës 2021 - 2025.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, gjatë periudhës janar - maj 2026 janë raportuar 9 raste të sulmeve fizike dhe jo-fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të medias, numër i cili ka arritur nivelin e tërë vitit 2025. Rastet kanë përfshirë sulme fizike, kërcënime, pengim në ushtrimin e profesionit dhe forma të tjera të cenimit të sigurisë së gazetarëve. Numri më i madh i rasteve është evidentuar në rajonin e Prishtinës.

Raporti evidenton se rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve kanë qenë vazhdimisht të pranishme edhe gjatë pesë viteve të fundit. Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2021 janë raportuar 18 raste, në vitin 2022 gjithsej 20 raste, në vitin 2023 janë evidentuar 33 raste, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 26 raste, ndërsa në vitin 2025 janë raportuar 9 raste. Vetëm gjatë pesë-mujorit të parë të vitit 2026 janë evidentuar po ashtu 9 raste, çka tregon se cenimi i sigurisë së gazetarëve vazhdon të mbetet problem serioz dhe i vazhdueshëm për lirinë e medias dhe ushtrimin e profesionit të gazetarisë në Kosovë.

Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar edhe raste serioze të kërcënimeve, sulmeve dhe fushatave të organizuara të presionit ndaj gazetarëve dhe mediave. Ndër rastet më shqetësuese të dokumentuara gjatë kësaj periudhe ishin kërcënimet serioze ndaj gazetarit Kushtrim Sadiku pas publikimit të dokumentarit të tij lidhur me Izraelin dhe zhvillimet në Lindjen e Mesme, sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarit Lirim Mehmetaj, sulmi fizik ndaj gazetarit Burim Pacolli, pengimi i gazetares Vesa Hoda nga pjesëtarë të sigurimit të Kryeministrit të Kosovës, si dhe kërcënimet ndaj ekipeve të mediave Nacionale dhe Betimi për Drejtësi brenda Gjykatës në Viti.

Gjatë periudhës janar - maj 2026 janë dokumentuar raste të kërcënimeve online, gjuhës së urrejtjes, fushatave denigruese dhe sulmeve kibernetike ndaj mediave dhe gazetarëve. Veçanërisht shqetësues konsiderohet rasti i gazetares investiguese Ardiana Thaçi-Mehmeti, e cila u bë cak i një fushate të koordinuar të ngacmimit online dhe dhunës digjitale me bazë gjinore, pas publikimeve të saj mbi sigurinë digjitale dhe grupet online që targetojnë gratë. Raporti thekson se gratë gazetare vazhdojnë të jenë veçanërisht të ekspozuara ndaj ngacmimeve seksiste, gjuhës së urrejtjes dhe sulmeve me bazë gjinore në hapësirën online.

Sipas të dhënave të siguruara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, gjatë periudhës janar - maj 2026 janë pranuar gjithsej 10 kallëzime penale që ndërlidhen me sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve dhe punonjësve medial. Nga këto raste, vetëm 4 kanë rezultuar me ngritje të aktakuzës, ndërsa rastet tjera kanë mbetur në procedurë hetimore. Në anën tjetër, raporti evidenton se mungesa e statistikave specifike nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me rastet që ndërlidhen me gazetarët dhe mediat tregon mungesë të monitorimit sistematik institucional dhe vështirëson analizimin e efikasitetit të sistemit gjyqësor në trajtimin e rasteve të tilla.

2. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti thekson gjithashtu mungesën e reagimeve të qarta dhe të qëndrueshme institucionale ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve dhe aktivistëve. Në një numër rastesh të dokumentuara gjatë kësaj periudhe, reagimet publike nga autoritetet shtetërore kanë qenë të vonuara ose kanë munguar plotësisht. Organizatat mediale kanë vlerësuar se mungesa e reagimeve institucionale dhe retorika stigmatizuese ndaj mediave nga akterë politik dhe institucional kontribuojnë në krijimin e një ambienti armiqësor ndaj gazetarisë kritike dhe raportimit në interes publik.

Gjetjet e raportit reflektohen edhe në vlerësimet ndërkombëtare mbi lirinë e medias në Kosovë. Raportet e Reporters Without Borders (RSF), Freedom House dhe European Commission kanë evidentuar shqetësime lidhur me sigurinë e gazetarëve, presionet politike ndaj mediave, vetëcensurën dhe mungesën e reagimit efektiv institucional. Veçanërisht shqetësuese konsiderohet rënia e Kosovës në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij, ku Kosova nga vendi i 56-të në vitin 2023 ka rënë në vendin e 99-të në vitin 2025, duke reflektuar përkeqësim të perceptimit ndërkombëtar lidhur me klimën për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në vend.

Raporti vlerëson se siguria e gazetarëve dhe mbrojtja efektive e lirisë së medias mbeten elemente thelbësore për funksionimin demokratik, sundimin e ligjit dhe transparencën institucionale në Kosovë. Sulmet, kërcënimet dhe format e ndryshme të presionit ndaj gazetarëve ndikojnë drejtpërdrejt jo vetëm në sigurinë individuale të tyre, por edhe në të drejtën e qytetarëve për informim të lirë, të pavarur dhe në interes publik.

Në funksion të përmirësimit të sigurisë së gazetarëve dhe garantimit të lirisë së medias në Kosovë, raporti rekomandon forcimin e reagimit institucional ndaj rasteve kundër gazetarëve, trajtimin prioritar të kallëzimeve penale që ndërlidhen me mediat, zhvillimin e mekanizmave për mbrojtje nga kërcënimet online dhe dhuna digjitale, krijimin e statistikave specifike institucionale për rastet që ndërlidhen me gazetarët, si dhe dënimin publik dhe të menjëhershëm të çdo sulmi apo kërcënimi ndaj mediave dhe gazetarëve.

3. HYRJE

Liria e shprehjes dhe liria e mediave garantohen me nenet 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Këto garanci imponojnë jo vetëm detyrimin e shtetit për të mos ndërhyrë në ushtrimin e veprimtarisë mediale, por edhe detyrimin pozitiv për të krijuar kushte efektive për ushtrimin e lirë dhe të sigurt të profesionit të gazetarisë.

Liria e medias dhe siguria e gazetarëve përbëjnë një nga shtyllat themelore të një shoqërie demokratike dhe të sundimit të ligjit. Gazetarët dhe punonjësit e mediave luajnë rol thelbësor në informimin e publikut, rritjen e transparencës institucionale dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të pushtetit. Për këtë arsye, çdo sulm, kërcënim apo formë presioni ndaj gazetarëve nuk cenon vetëm sigurinë individuale të tyre, por ndikon drejtpërdrejt edhe në lirinë e shprehjes, pluralizmin mediatik dhe të drejtën e qytetarëve për informim të pavarur dhe në interes publik.

Gjatë viteve të fundit, siguria e gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Kosovë ka vazhduar të mbetet shqetësim serioz për organizatat mediale, institucionet vendore dhe mekanizmat ndërkombëtarë që monitorojnë lirinë e medias. Sulmet fizike, kërcënimet verbale, fushatat denigruese, presionet politike dhe institucionale, si dhe sulmet online dhe kibernetike ndaj gazetarëve dhe mediave, kanë krijuar një ambient të pasigurt për ushtrimin e profesionit të gazetarisë. Në veçanti, zhvillimi i hapësirës digjitale dhe rritja e përdorimit të rrjeteve sociale kanë ndikuar në rritjen e kërcënimeve online, gjuhës së urrejtjes dhe fushatave të koordinuara të sulmeve ndaj gazetarëve, veçanërisht ndaj grave gazetare dhe gazetarëve investigativ.

Raportet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë Reporters Without Borders, Freedom House dhe European Commission, kanë evidentuar vazhdimisht shqetësime lidhur me lirinë e medias në Kosovë, duke theksuar problemet që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve, presionet politike, mungesën e transparencës institucionale dhe nivelin e ulët të reagimit ndaj sulmeve kundër mediave dhe gazetarëve. Në këtë kontekst, vetëcensura mbetet një nga pasojat më shqetësuese të klimës së pasigurisë për gazetarët, pasi frika nga sulmet, kërcënimet apo pasojat profesionale mund të ndikojë drejtpërdrejt në raportimin mbi temat me interes publik.

Ky raport është hartuar nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës në kuadër të projektit “Forcimi i Lirisë së Medias, Bashkëpunimit Ndëretnik dhe Luftimit të Gjuhës së Urrejtjes në Kosovë”, me mbështetjen e UNMIK-ut. Qëllimi i raportit është të ofrojë një pasqyrë të gjendjes së sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Kosovë gjatë periudhës janar - maj 2026, përmes analizimit të të dhënave institucionale, rasteve të dokumentuara dhe zhvillimeve kryesore që ndërlidhen me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në vend.

Raporti bazohet në të dhënat e siguruar nga Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe në raportet dhe publikimet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare relevante. Përmes këtij raporti synohet jo vetëm dokumentimi i rasteve dhe trendeve kryesore, por edhe identifikimi i sfidave institucionale dhe formulimi i rekomandimeve konkrete për përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt për ushtrimin e lirë dhe të pavarur të profesionit të gazetarisë në Kosovë.

dhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë, të cilët në raportet e tyre kanë evidentuar shqetësime të vazhdueshme lidhur me presionet ndaj mediave, sigurinë e gazetarëve, vetëcensurën dhe klimën për raportim kritik në vend. Vlerësimet ndërkombëtare përbëjnë indikator të rëndësishëm për të kuptuar trendet e zhvillimit të lirisë së medias dhe nivelin e mbrojtjes së gazetarëve në Kosovë.


Një nga mekanizmat më të rëndësishëm ndërkombëtarë në këtë fushë është Reporters Without Borders (RSF), e cila publikon çdo vit Indeks Botëror të Lirisë së Shtypit për 180 shtete të botës. Ky indeks vlerëson gjendjen e lirisë së medias duke marrë parasysh faktorë si pavarësia editoriale, pluralizmi mediatik, siguria e gazetarëve, presionet politike dhe ekonomike, si dhe qasja në informacion publik.

Renditja e Kosovës në këtë indeks gjatë viteve të fundit ka shënuar luhatje të konsiderueshme. Në vitin 2021 Kosova ishte renditur në vendin e 78-të, në vitin 2022 në vendin e 61-të, ndërsa në vitin 2023 kishte arritur pozitën e 56-të. Megjithatë, gjatë viteve të fundit është evidentuar përkeqësim i dukshëm i renditjes, ku në vitin 2024 Kosova ra në vendin e 75-të, ndërsa në vitin 2025 në vendin e 99-të nga 180 shtete të përfshira në indeks.

Në grafikën e mëposhtme janë paraqitur ndryshimet vjetore të renditjes së Kosovës në Indeks Botëror të Lirisë së Shtypit gjatë periudhës 2021–2025.

Grafika 1. Renditja e Kosovës në Indeks Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij gjatë viteve 2021 – 2025.

Pozicion më i ulët = renditje më e mirë (nga 180 vende)



Rënia e Kosovës nga vendi i 56-të në vitin 2023 në vendin e 99-të në vitin 2025 paraqet një regres serioz në fushën e lirisë së medias dhe reflekton përkeqësim të perceptimit ndërkombëtar lidhur me sigurinë e gazetarëve, pavarësinë editoriale dhe klimën për raportim kritik. Organizatat mediale dhe mekanizmat monitorues kanë vlerësuar se një trend i tillë lidhet me rritjen e presioneve ndaj mediave, gjuhën stigmatizuese ndaj gazetarëve, sulmet online dhe mungesën e reagimeve institucionale ndaj rasteve që cenojnë lirinë e medias.

Edhe Freedom House në raportet e saj vjetore ka evidentuar sfida të vazhdueshme lidhur me lirinë e medias dhe klimën për raportim kritik në Kosovë. Sipas raportit “Freedom in the World – Kosovo”, Kosova vazhdon të klasifikohet si vend “Pjesërisht i lirë” (“Partly Free”), me 60 pikë nga 100 gjithsej, prej të cilave 28 pikë në kategorinë e të drejtave politike dhe 32 pikë në kategorinë e lirisë civile. Ndërkaq, sipas raportit të vitit 2026 të Freedom House, Kosova vazhdon të mbetet në kategorinë e vendeve “Pjesërisht të lira”, por ka shënuar përmirësim të lehtë duke arritur 61 pikë nga 100, krahasuar me 60 pikë në raportin paraprak.

Ngjajshëm, United States Department of State në Raportin për të Drejtat e Njeriut për vitin 2024 ka evidentuar shqetësime lidhur me presionet ndaj gazetarëve, fushatat denigruese ndaj mediave dhe vështirësitë në qasjen në dokumente dhe informacione publike. Raporti po ashtu evidenton shqetësimet e ngritura nga organizatat mediale lidhur me klimën jo të favorshme për raportim kritik dhe sigurinë e gazetarëve në Kosovë.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2025 thekson se Kosova ka një nivel të caktuar të përgatitjes në fushën e lirisë së shprehjes, por nuk ka shënuar progres. Raporti evidenton se rekomandimet e vitit paraprak mbeten ende të pa implementuara, veçanërisht ato që ndërlidhen me forcimin e mekanizmave institucional për mbrojtjen e gazetarëve, trajtimin e rasteve të kërcënimeve dhe dhunës ndaj mediave, si dhe garantimin e pavarësisë dhe funksionalitetit të institucioneve rregullatore mediale.

Gjetjet e këtyre raporteve ndërkombëtare përputhen në masë të madhe edhe me rastet dhe trendet e dokumentuara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës gjatë viteve të fundit. Në mënyrë të veçantë, ato reflektojnë shqetësimet lidhur me rritjen e presioneve ndaj gazetarëve, sulmet online, retorikën stigmatizuese ndaj mediave dhe mungesën e reagimeve të qëndrueshme institucionale ndaj rasteve që cenojnë sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias në Kosovë.


Institucionet ndërkombëtare e kanë karakterizuar median si një nga shtyllat themelore të një shoqërie demokratike dhe të sundimit të ligjit. Për rrjedhojë, gazetarët duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarisë, duke pasur parasysh rolin e tyre në informimin e publikut dhe mbikëqyrjen e institucioneve publike. Në këtë kontekst, institucionet e drejtësisë kanë obligim jo vetëm të përmbahen nga ndërhyrjet e pajustificuara në veprimtarinë mediale, por edhe të garantojnë hetim efektiv, ndjekje të duhur dhe mbrojtje adekuate në rastet e sulmeve, kërcënimeve apo formave të tjera të intimidimit ndaj gazetarëve.

Gjatë 5 viteve të fundit (2021–2025), siguria e gazetarëve dhe punonjësve të mediave në Kosovë ka vazhduar të përballet me sfida serioze që ndërlidhen me sulmet fizike dhe verbale, kërcënimet, presionet politike, pengimin në ushtrimin e profesionit dhe format e ndryshme të sulmeve në hapësirën digjitale. Të dhënat e Policisë së Kosovës, rastet e dokumentuara nga vetë AGK dhe raportet e organizatave ndërkombëtare tregojnë se siguria e gazetarëve dhe hapësira për raportim kritik vazhdojnë të mbeten çështje shqetësuese për lirinë e medias në Kosovë.

Gjatë vitit 2021 në Policinë e Kosovës janë raportuar 18 raste që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve dhe të punësuarve në media. Në vitin 2022 numri i rasteve është rritur në 20, ndërsa gjatë vitit 2023 është evidentuar rritje e ndjeshme e rasteve, me gjithsej 33 raste të regjistruara. Në vitin 2024 janë regjistruar 26 raste, ndërsa gjatë vitit 2025 janë evidentuar 9 raste.

Të dhënat në lidhje me rastet e trajtuara nga Policia e Kosovës përgjatë këtyre viteve janë paraqitur edhe në grafikën e mëposhtme.

Grafika 2. Numri i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës mbi veprat penale ndaj gazetarëve (2021 - 2025).



Pavarësisht se të dhënat ndër vite janë karakterizuar me ndryshime të theksuara njëra ndaj tjetrës, sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve janë karakterizuar si fenomen negativ në rritje kundër lirisë së medias dhe ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë. Në këtë kuadër, një pjesë e konsiderueshme e presioneve ndaj gazetarëve nuk reflektohet gjithmonë në statistikat zyrtare të rasteve të raportuara në institucione, për shkak se jo të gjitha format e cenimit raportohen si raste penale.

Në veçanti, deklaratat publike nga lidhshipi politik që përmbajnë gjuhë inflamatore, stigmatizuese ose polarizuese ndaj mediave dhe gazetarëve, edhe kur nuk përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë, mund të krijojnë një klimë të përgjithshme armiqësore dhe të shërbejnë si faktor nxitës për presione apo kërcënim të mëvonshme nga palë të treta. Këto forma të ndikimit shpesh nuk raportohen në polici, pasi nuk perceptohen si vepra të drejtpërdrejta penale, por megjithatë kanë efekt të rëndësishëm në sigurinë dhe lirinë e ushtrimit të profesionit të gazetarisë.

Incidentet më të zakonshme kanë përfshirë kërcënimet verbale, shpifje dhe fushata diskredituese në rrjete sociale, deri te sulmet fizike në terren, sidomos gjatë mbulimit mediatic të protestave dhe ngjarjeve me tension politik në veri të vendit, ku gazetarët janë përballur me dhunë, dëmtim apo marrje të pajisjeve të punës, dëmtim të automjeteve dhe pengim fizik gjatë procesit të punës. Autorët kanë qenë të ndryshëm, duke filluar nga individë të caktuar të nxitur nga retorika publike, deri te akterët politik apo struktura të organizuara, që e shohin median si kërcënim për interesat e tyre.

Gjatë viteve të fundit është vërejtur veçanërisht rritje e sulmeve dhe kërcënimeve në hapësirën digjitale, përfshirë gjuhën e urrejtjes, fushatat denigruese dhe sulmet online ndaj gazetarëve dhe mediave. Në shumicën e rasteve, sulmet dhe kërcënimet e natyrës që nuk vlerësohen si rrezik i menjëhershëm për jetën nuk raportohen në polici. Këto kërcënime dhe kjo gjuhë e papërshtatshme veçanërisht shënjestrojnë gazetaret gra dhe gazetarët hulumtues.

Polarizimi politik dhe retorika stigmatizuese ndaj mediave kanë kontribuar në krijimin e një ambienti të pafavorshëm për gazetarinë kritike në Kosovë. Organizatat mediale kanë theksuar se etiketimi i gazetarëve dhe mediave nga akterë politik dhe institucional mund të ndikojë drejtpërdrejt në cenimin e sigurisë së gazetarëve dhe në uljen e besimit publik ndaj mediave. Ndonëse në komunitetin e gazetarëve ekziston një nivel solidariteti, ai shpesh është i fragmentuar dhe jo i qëndrueshëm. Në disa raste, këto retorika stigmatizuese vijnë edhe nga vetë gazetarë të pakënaqur me kolegët e tyre. Reagimet ndaj kërcënimeve ose sulmeve kanë qenë të kufizuara dhe jo gjithmonë mirë të koordinuara. Organizatat monitoruese kanë vlerësuar se reagimi publik ndaj sulmeve kundër gazetarëve shpesh nuk ka qenë i njëtrajtshëm dhe proporcional me seriozitetin e incidenteve të raportuara.

Kërcënimet dhe presionet ndaj gazetarëve kanë ndikuar edhe në rritjen e vetëcensurës, veçanërisht në raportimin mbi tema të ndjeshme si korrupsioni, krimi i organizuar dhe abuzimi me pushtetin. Frika nga sulmet dhe mungesa e mbrojtjes efektive institucionale mund të ndikojnë drejtpërdrejt në lirinë e gazetarëve për të raportuar në mënyrë të pavarur dhe kritike. Përveç kësaj, frika e vazhdueshme nga sulmet e tilla ka kufizuar lirinë e tyre për të raportuar lirshëm në terren. Në këtë mënyrë, jo vetëm që është cenuar siguria e gazetarëve, por është cenuar edhe cilësia apo e drejta e informimit që do të duhej t'u ofrohej qytetarëve të Republikës së Kosovës.


Shqetësimet lidhur me sigurinë e gazetarëve dhe klimën për raportim kritik reflektohen edhe në vlerësimet ndërkombëtare mbi lirinë e medias. Veçanërisht shqetësuese konsiderohet rënia e Kosovës në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij, ku Kosova nga vendi i 56-të në vitin 2023 ka rënë në vendin e 99-të në vitin 2025. Ky regres reflekton përkeqësim të perceptimit ndërkombëtar lidhur me sigurinë e gazetarëve, presionet ndaj mediave dhe klimën për raportim kritik në Kosovë.

6.1 RASTET E RAPORTUARA NË POLICINË E KOSOVËS

Në pjesën vijuese të këtij kapitulli janë paraqitur statistikat zyrtare të pranuar nga Policia e Kosovës mbi rastet e sulmeve me natyrë fizike dhe jo-fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave, të raportuara gjatë pesë mujorit të parë të vitit 2026 (janar – maj).

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, gjatë 5 mujorit të parë të vitit 2026 janë raportuar 9 raste me karakter fizik dhe jo-fizik ndaj gazetarëve, me gjithsej 11 persona të përfshirë.

Tabela 1. Numri i rasteve ndaj gazetarëve të raportuara në Policinë e Kosovës gjatë periudhës janar – maj 2026.



Në vetëm 5 muaj të vitit 2026, u arrit numri i përgjithshëm i rasteve nga 1 GJITHË viti 2025.

Statistikat e paraqitura më lartë tregojnë qartë se dhuna fizike ndaj gazetarëve në Kosovë nuk është një dukuri e izoluar, por një problem sistematik dhe i përsëritur që dëmton rëndë sigurinë profesionale të gazetarëve dhe lirinë e medias.

Krahasuar me vitin 2025, kur gjatë tërë vitit ishin raportuar gjithashtu 9 raste, të dhënat tregojnë se vetëm në pesë muajt e parë të vitit 2026 është arritur numri i përgjithshëm i rasteve të vitit paraprak. Ky trend tregon rritje të intensitetit të kërcënimeve dhe presioneve ndaj gazetarëve dhe mediave në Kosovë, si dhe nevojë për reagim më efektiv institucional në trajtimin dhe parandalimin e rasteve të tilla.

Për shkak të specifikave dhe rolit që gazetarët ushtrojnë në një shoqëri demokratike, sulmet dhe kërcënimet ndaj tyre nuk duhet të trajtohen vetëm si raste penale të zakonshme, por edhe si çështje që prekin drejtpërdrejt ushtrimin e lirisë së medias dhe të drejtën e publikut për informim. Për këtë arsye, standardet ndërkombëtare kërkojnë reagim të shpejtë, efektiv dhe proporcional nga institucionet përgjegjëse, duke siguruar hetim të plotë të motiveve që lidhen me veprimtarinë profesionale të gazetarit. Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së medias në një shoqëri demokratike, reagimi institucional ndaj sulmeve, kërcënimeve dhe formave të tjera të pengimit të gazetarëve duhet, për nga serioziteti dhe prioriteti i trajtimit, të ngrihet në një nivel të krahasueshëm me rastet e pengimit të personit në kryerjen e detyrës zyrtare.

Rritja e rasteve gjatë vitit 2026 ndërlidhet edhe me polarizimin politik, rritjen e sulmeve online, retorikën stigmatizuese ndaj mediave dhe tensionet e vazhdueshme politike në vend. Organizatat mediale kanë theksuar se klima e krijuar ndaj mediave dhe gazetarëve ka ndikuar në shtimin e kërcënimeve, presioneve dhe fushatave të organizuara të denigrimit ndaj raportimit kritik dhe gazetarisë në interes publik.

6.1 RASTET E RAPORTUARA NË POLICINË E KOSOVËS

Sipas të dhënave të pranuar nga Policia e Kosovës, rastet e sulmeve fizike dhe jo-fizike ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave gjatë periudhës janar – maj 2026 janë raportuar në katër rajone të Kosovës. Numri më i madh i rasteve është evidentuar në rajonin e Prishtinës, ku janë raportuar gjithsej 6 raste që përfshijnë gazetarë dhe punonjës të mediave. Ndërkaq, në rajonet e Gjilanit, Ferizajt dhe Mitrovicës së Jugut është raportuar nga një rast, ndërsa në rajonet tjera nuk janë evidentuar raste të raportuara gjatë kësaj periudhe.

Tabela 2. Rajonet ku janë raportuar rastet në Policinë e Kosovës gjatë periudhës janar – maj 2026.



Madhësia e rrethit përfaqëson përqindjen e numrit të përgjithshëm të rasteve. Prishtina përbën 67% të të gjitha incidenteve të raportuara.

Statistikat e paraqitura më lartë tregojnë qartë se dhuna fizike ndaj gazetarëve në Kosovë nuk është një dukuri e izoluar, por një problem sistematik dhe i përsëritur që dëmton rëndë sigurinë profesionale të gazetarëve dhe lirinë e medias.

Krahasuar me vitin 2025, kur gjatë tërë vitit ishin raportuar gjithashtu 9 raste, të dhënat tregojnë se vetëm në pesë muajt e parë të vitit 2026 është arritur numri i përgjithshëm i rasteve të vitit paraprak. Ky trend tregon rritje të intensitetit të kërcënimeve dhe presioneve ndaj gazetarëve dhe mediave në Kosovë, si dhe nevojë për reagim më efektiv institucional në trajtimin dhe parandalimin e rasteve të tilla.

Për shkak të specifikave dhe rolit që gazetarët ushtrojnë në një shoqëri demokratike, sulmet dhe kërcënimet ndaj tyre nuk duhet të trajtohen vetëm si raste penale të zakonshme, por edhe si çështje që prekin drejtpërdrejt ushtrimin e lirisë së medias dhe të drejtën e publikut për informim. Për këtë arsye, standardet ndërkombëtare kërkojnë reagim të shpejtë, efektiv dhe proporcional nga institucionet përgjegjëse, duke siguruar hetim të plotë të motiveve që lidhen me veprimtarinë profesionale të gazetarit. Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së medias në një shoqëri demokratike, reagimi institucional ndaj sulmeve, kërcënimeve dhe formave të tjera të pengimit të gazetarëve duhet, për nga serioziteti dhe prioriteti i trajtimit, të ngrihet në një nivel të krahasueshëm me rastet e pengimit të personit në kryerjen e detyrës zyrtare.

Rritja e rasteve gjatë vitit 2026 ndërlihet edhe me polarizimin politik, rritjen e sulmeve online, retorikën stigmatizuese ndaj mediave dhe tensionet e vazhdueshme politike në vend. Organizatat mediale kanë theksuar se klima e krijuar ndaj mediave dhe gazetarëve ka ndikuar në shtimin e kërcënimeve, presioneve dhe fushatave të organizuara të denigrimit ndaj raportimit kritik dhe gazetarisë në interes publik.

Gjatë kësaj periudhe është vërejtur gjithashtu rritje e dukshme e rasteve që ndërlihen me kërcënimet online, fushatat e koordinuara të denigrimit dhe sulmet kibernetike ndaj gazetarëve dhe mediave, çka tregon zhvendosjen e një pjese të konsiderueshme të presioneve ndaj mediave në hapësirën digjitale. Organizatat monitoruese kanë theksuar se mungesa e mekanizmave efektivë për trajtimin e këtyre rasteve vazhdon të mbetet sfidë serioze për sigurinë e gazetarëve dhe mbrojtjen e lirisë së medias në Kosovë.

6.2 RASTET MË SHQETËSUESE TË EVIDENTUARA GJATË PERIUdhËS JANAR – MAJ 2026

Gjatë pesë-mujorit të parë të vitit 2026 janë evidentuar disa raste serioze që ndërlidhen me cenimin e sigurisë së gazetarëve dhe pengimin e ushtrimit të profesionit të gazetarisë në Kosovë. Rastet e raportuara kanë përfshirë kërcënime me jetë, sulme fizike, pengim gjatë raportimit, fushata denigruese dhe forma të ndryshme të presionit institucional dhe online ndaj gazetarëve dhe mediave. Organizatat monitoruese kanë vlerësuar se natyra dhe serioziteti i këtyre rasteve paraqesin shqetësim serioz për lirinë e medias dhe klimën për raportim kritik në Kosovë.

KËRCËNIMET SERIOZE ME
JETË

SULMET FIZIKE DHE
PENGIMI

SULMET ONLINE DHE
SULMET KIBERNETIKE

KËRCËNIMET SERIOZE ME JETË NDAJ GAZETARËVE

Një nga rastet më serioze të evidentuara gjatë kësaj periudhe ishte ai i gazetarit Kushtrim Sadiku, i cili u përball me kërcënime serioze lidhur me punën e tij profesionale. Pas publikimit të dokumentarit të tij lidhur me Izraelin dhe zhvillimet në Lindjen e Mesme, gazetari ishte përballur me sulme të vazhdueshme online, linçime publike dhe kërcënime ndaj tij dhe familjes së tij nga persona dhe grupe të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës.

Rasti u konsiderua veçanërisht shqetësues për shkak se kërcënimet ndaj gazetarit ndërlidheshin drejtpërdrejt me përmbajtjen editoriale dhe raportimin në interes publik. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe SafeJournalists Network reagues publikisht duke kërkuar hetim të shpejtë dhe mbrojtje efektive për gazetarin dhe familjen e tij. Ky rast ilustron rritjen e kërcënimeve ndaj gazetarëve për shkak të raportimit mbi tema sensitive dhe çështje me interes të lartë publik.

Rast tjetër shqetësues ishte ai i gazetarit **Lirim Mehmetaj**, i cili kishte marrë kërcënim serioz me jetë në rrjetin social "Facebook". Në një prej komenteve në këtë rrjet social të gazetarit ishte thënë: "3 okfira me ti shpraz nlul tballit frik e kie". Rasti u vlerësua si veçanërisht serioz për shkak të natyrës së drejtpërdrejtë të kërcënimit dhe gjuhës së përdorur ndaj gazetarit. Organizatat monitoruese reagues duke theksuar se kërcënimet me jetë ndaj gazetarëve cenojnë drejtpërdrejt sigurinë personale të tyre dhe krijojnë efekt frikësues për raportimin kritik në interes publik.

SULMET FIZIKE DHE PENGIMI I GAZETARËVE GJATË RAPORTIMIT

Gjatë kësaj periudhe monitoruese u evidentua edhe sulmi fizik ndaj gazetarit **Burim Pacolli**, rast për të cilin reagues AGK dhe Committee to Protect Journalists (CPJ). Sipas raportimeve publike, sulmi ndaj gazetarit ishte kryer më 2 mars 2026 në Prishtinë nga këngëtari Gramos Krasniqi (i njohur për publikun e tij si “Mossi”) dhe disa persona të tjerë, si hakmarrje ndaj një vlerësimi negativ që gazetari kishte bërë për muzikën e tij.

Veçanërisht shqetësues konsiderohej fakti se pas sulmit fizik kërcënimet kishin vazhduar edhe online, përfshirë publikimin e mesazheve kërcënuese në rrjete sociale. Sipas deklarimeve publike të gazetarit, ai kishte vazhduar të merrte kërcënime dhe kishte shprehur frikë për sigurinë e tij dhe familjes së tij.

Rasti i gazetares **Vesa Hoda** u konsiderua po ashtu ndër rastet më shqetësuese të evidentuara gjatë kësaj periudhe, për shkak se incidenti ndërlidhej drejtpërdrejt me pengimin e ushtrimit të profesionit nga pjesëtarë të sigurimit të Kryeministrit të Kosovës. AGK kishte reaguar duke theksuar se pengimi i gazetarëve nga persona përgjegjës për sigurinë e zyrtarëve shtetërorë paraqet cenim serioz të lirisë së medias dhe të drejtës së gazetarëve për të ushtruar profesionin pa presion dhe intimidim.

Një rast tjetër i evidentuar gjatë periudhës raportuese ishte edhe ai i gazetarit **Benjamin Kurti**, i cili u përball me pengim gjatë ushtrimit të detyrës profesionale në Vushtrri. Incidenti kishte ndodhur në ambientet e Ndërmarrjes publike të Ujësjiellit në Vushtrri, ku drejtori i këtij institucioni kishte tentuar t’ia marrë telefonin gazetarit pasi ai kishte parashtruar pyetje lidhur me ankesat e qytetarëve. Organizatat mediale e vlerësuan rastin si formë të presionit ndaj gazetarit gjatë raportimit mbi çështje me interes publik.

Po ashtu, më 7 maj 2026 në Ferizaj u raportua sulm ndaj ekipit të Klan Kosova, përkatësisht ndaj gazetarëve **Qëndresa Tërshani dhe Arben Restelica** gjatë raportimit në terren. Organizatat mediale vlerësuan se raste të tilla kontribuojnë në krijimin e ambientit të pasigurt për raportim të lirë dhe kritik nga terreni.

Më 30 janar 2026, ekipet e mediave **Nacionale dhe Betimi për Drejtësi** u kërcënuan brenda objektit të Gjykatës në Viti gjatë raportimit për një kontest pronësor. Ndaj gazetarëve **Eriola Cacaj, Drilon Namani dhe Flamur Kabashi** ishte bërë gjesti i “heqjes së kokës”, ndërsa rasti ishte raportuar në polici. Organizatat mediale e konsideruan veçanërisht shqetësues faktin se kërcënimi ndodhi brenda një institucioni të drejtësisë gjatë ushtrimit të profesionit të gazetarisë.

SULMET ONLINE DHE SULMET KIBERNETIKE NDAJ MEDIAVE

Gjatë kësaj periudhe u evidentuan edhe raste serioze të sulmeve online dhe kibernetike ndaj mediave dhe gazetarëve. Një nga rastet më shqetësuese ishte ai i gazetares investigative Ardiana Thaçi-Mehmeti, e cila u bë cak i një fushate të koordinuar të ngacmimit online dhe dhunës digjitale me bazë gjinore. Pas angazhimit të saj publik lidhur me sigurinë digjitale dhe grupet online që targetojnë gratë, ndaj gazetares u shpërndanë përmbajtje fyese, seksiste dhe denigruese, ndërsa në platforma online u publikuan të dhëna personale dhe komente me përmbajtje kërcënuese.

Ky rast u konsiderua ilustrues i rritjes së dhunës digjitale ndaj grave gazetare dhe i mënyrës se si sulmet online synojnë jo vetëm frikësimin e gazetarëve, por edhe diskreditimin profesional dhe kufizimin e pjesëmarrjes së tyre në debat publik dhe raportim kritik.

Ndërkaq, gjatë kësaj periudhe u evidentuan edhe sulme kibernetike ndaj mediave VOX Kosova dhe Reporteri.net. Sipas raportimeve, llogaritë e këtyre mediave në rrjete sociale ishin sulmuar dhe pezulluar përkohësisht, duke ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e tyre dhe shpërndarjen e përmbajtjes mediale. Organizatat monitoruese vlerësuan se sulmet kibernetike ndaj mediave cenojnë jo vetëm sigurinë digjitale të redaksive, por edhe qasjen e publikut në informacion.

Më 20 maj 2026, portali Paparaci raportoi se ishte bërë përsëri cak i sulmit ndaj redaksisë, rast i cili u dokumentua edhe nga AGK dhe SafeJournalists Network. Sipas reagimeve publike, incidenti kishte të bënte me prerjen e përsëritur të kabllove të internetit në ndërtesën ku ndodhet redaksia e mediumit. Rasti u konsiderua shqetësues për shkak të natyrës së përsëritur të incidentit dhe faktit se ndërhyrjet ndaj infrastrukturës teknike të mediave mund të ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin e redaksive dhe qasjen e publikut në informacion.

Përveç sulmeve dhe kërcënimeve direkte, gjatë kësaj periudhe u evidentuan edhe raste të retorikës stigmatizuese dhe denigruese ndaj mediave dhe gazetarëve nga përfaqësues politik dhe institucional, të cilat janë trajtuar më gjerësisht në Kapitullin 8 të këtij raporti.

Rastet e evidentuara gjatë periudhës janar – maj 2026 tregojnë se gazetarët në Kosovë vazhdojnë të përballen me forma të ndryshme të cenimit të sigurisë së tyre, duke filluar nga kërcënimet me jetë dhe sulmet fizike, deri te presionet institucionale, dhuna digjitale dhe sulmet kibernetike ndaj mediave. Natyra e rasteve të raportuara tregon gjithashtu se presionet ndaj gazetarëve nuk kufizohen vetëm në terren, por janë shtrirë gjithnjë e më shumë edhe në hapësirën online dhe në diskursin publik, duke krijuar ambient të pasigurt për raportim kritik dhe gazetari në interes publik.

Ndaj të gjitha këtyre rasteve, si dhe rasteve të tjera të evidentuara gjatë periudhës raportuese, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës kishte reaguar publikisht duke dënuar sulmet, kërcënimet dhe format e ndryshme të presionit ndaj gazetarëve, punonjësve medial dhe mediave në Kosovë. Në reagimet e saj publike, AGK kishte kërkuar trajtim urgjent institucional, hetim efektiv të rasteve dhe reagim të menjëhershëm nga autoritetet përgjegjëse, duke theksuar se sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve cenojnë drejtpërdrejt lirinë e medias, sigurinë e gazetarëve dhe të drejtën e qytetarëve për informim të lirë dhe në interes publik.

6.3 DIMENSIONI GJINOR I RASTEVE TË RAPORTUARA NË POLICINË E KOSOVËS

Gratë gazetare në Kosovë vazhdojnë të përballen me një spektër të gjerë sfidash që lidhen me sigurinë e tyre profesionale dhe personale. Këto sfida shtrihen nga kërcënimet dhe ngacmimet në rrjete sociale, komentet seksiste dhe fushatat e linçimit online, deri tek kërcënimet direkte, presionet institucionale dhe, në raste të caktuara, paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).

Sipas të dhënave të pranuar nga Policia e Kosovës, gjatë periudhës janar - maj 2026 ishin raportuar 9 raste që përfshinin 11 gazetarë dhe punonjës të mediave që ndërlidhen me sulme fizike dhe jo fizike ndaj tyre, prej të cilëve 10 ishin burra dhe 1 ishte grua.




Tabela 2. Shpërndarja gjinore e rasteve të raportuara nga burrat dhe gratë në Policinë e Kosovës gjatë periudhës janar - maj 2026.

Dominimi i burrave në statistikat zyrtare të rasteve të raportuara nuk nënkupton domosdoshmërisht se gratë gazetare janë më pak të ekspozuara ndaj sulmeve dhe kërcënimeve. Organizatat monitoruese kanë theksuar vazhdimisht se gratë gazetare shpesh përballen me forma të ndryshme të ngacmimit dhe dhunës online, të cilat në shumë raste nuk raportohen fare tek institucionet përgjegjëse.

Në fakt, një pjesë e konsiderueshme e gjuhës së papërshtatshme, linçimeve dhe komenteve denigruese në hapësirën online që krijojnë klimë armiqësore dhe mund të shërbejnë si bazë për kërcënime të mëvonshme, nuk raportohet në polici, shpesh për arsye të ndryshme, përfshirë mosbesimin në efektivitetin e reagimit institucional apo perceptimin se këto raste nuk do të trajtohen si çështje penale. Në këtë kuptim, edhe kur bëhet fjalë për gra gazetare, një pjesë e madhe e përvojave të tyre me linçim online mbetet jashtë statistikave zyrtare.

Nga ana tjetër, edhe në rastet kur raportohen, institucionet e zbatimit të ligjit shpesh nuk i trajtojnë komentet apo gjuhën denigruese që nuk përmbajnë elemente të drejtpërdrejta kriminale si kërcënim të menjëhershëm, duke ndikuar kështu në perceptimin e ulët të seriozitetit të këtyre formave të cenimit. Megjithatë, organizatat e shoqërisë civile theksojnë se gratë gazetare janë veçanërisht të ekspozuara ndaj formave të tilla të abuzimit, ku dimensionin gjinor ndërthuret ngushtë me rolin e tyre profesional. Përvojat individuale të gazetareve gjithashtu ndryshojnë sa i përket natyrës së sulmeve dhe mënyrës se si ato i perceptojnë dhe i raportojnë kërcënimet.

Sulmet me bazë gjinore dhe ngacmimet online ndaj grave gazetare shpesh kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në pjesëmarrjen e tyre në debatin publik dhe ushtrimin e profesionit. Organizatat monitoruese kanë theksuar se gjuha seksiste, kërcënimet dhe fushatat e koordinuara të linçimit online mund të shkaktojnë pasoja psikologjike, përfshirë ankth, stres dhe tërheqje nga raportimi publik, duke kontribuar në forma të heshtura të vetëcensurës.

Në kuadër të dimensionit gjinor të rasteve të raportuara gjatë vitit 2026, veçanërisht shqetësues mbetet rasti i gazetares investigative Ardiana Thaçi-Mehmeti, i cili nxori në pah ekspozimin e grave gazetare ndaj formave specifike të dhunës dhe presionit online. Pas angazhimit të saj publik lidhur me çështje të sigurisë digjitale dhe grupeve online që targetojnë gratë, gazetarja u përball me një valë të koordinuar të sulmeve në hapësirën virtuale.

Sipas reagimeve të organizatave mediale dhe mekanizmave rajonalë për mbrojtjen e gazetarëve, ndaj Thaçi-Mehmetit u shpërndanë përmbajtje fyese dhe denigruese me karakter seksist, ndërsa në platforma online u publikuan të dhëna personale dhe komente me përmbajtje kërcënuese.

Ky rast u konsiderua ilustrues i mënyrës se si gratë gazetare shpesh përballen me forma të ndryshme të dhunës digjitale që ndërlidhen jo vetëm me punën e tyre profesionale, por edhe me gjininë e tyre.

7. TRAJTIMI I KALLËZIMEVE PENALE QË NDËRLIDHEN ME GAZETARËT NGA PROKURORITË THEMELORE TË KOSOVËS


Trajtimi efektiv i rasteve që ndërlidhen me sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve përbën një nga elementet kyçe për garantimin e lirisë së medias dhe forcimin e besimit të gazetarëve në institucionet e drejtësisë. Efikasiteti i hetimeve dhe procedurave penale në rastet që prekin sigurinë e gazetarëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në parandalimin e mos-ndëshkueshmërisë dhe krijimin e një ambienti më të sigurt për raportim kritik dhe gazetari në interes publik.

Në këtë kapitull janë paraqitur të dhënat statistikore të siguruara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, lidhur me kallëzimet penale të pranuar nga Prokuroritë Themelore në Kosovë për rastet që ndërlidhen me sulmet, kërcënimet dhe cenimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve të mediave gjatë periudhës janar-maj 2026.

Të dhënat tregojnë se numri më i lartë i rasteve është evidentuar në rajonin e Prishtinës, gjë që ndërlidhet edhe me përqendrimin më të madh të institucioneve publike, mediave kombëtare dhe aktiviteteve politike në vend. Dominimi i rasteve në këtë rajon reflekton gjithashtu faktin se pjesa më e madhe e raportimit mbi çështjet politike, institucionale dhe temat e ndjeshme zhvillohet pikërisht në Prishtinë, ku gazetarët dhe ekipet mediale janë më të ekspozuara ndaj formave të ndryshme të presionit dhe kërcënimeve.

PROKURORITË THEMELORE	KALLËZIME PENALE TË PRANUARA	AKTAKUZA TË NGRITURA	RASTE NË PROCEDURË
Prishtina	9	3	6
Gjilan	1	1	0
Gjakova	0	0	0
Ferizaj	0	0	0
Prizren	0	0	0
Mitrovica	0	0	0
Peja	0	0	0
TOTAL	10	4	6

Tabela 4. Numri i kallëzimeve penale të pranuar nga Prokuroritë Themelore për vepra të ndryshme penale ndaj gazetarëve gjatë periudhës janar-maj 2026.



Të dhënat tregojnë se shumica e rasteve vazhdojnë të mbeten në procedurë, ndërsa numri relativisht i ulët i aktakuzave të ngritura (4 aktakuza) ngrit shqetësime lidhur me efikasitetin institucional në trajtimin e rasteve që prekin sigurinë e gazetarëve. Mungesa e rezultateve konkrete në trajtimin e rasteve që ndërlidhen me gazetarët dhe punonjësit të mediave vazhdon të mbetet shqetësim serioz për organizatat mediale dhe mekanizmat monitorues. Zvarritja e procedurave dhe mungesa e transparencës lidhur me ecurinë e rasteve mund të kontribuojnë në krijimin e perceptimit të mos-ndëshkueshmërisë dhe të ndikojnë negativisht në besimin e gazetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë.

Megjithëse nuk janë evidentuar fare kallëzime penale në disa prokurori, kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht mungesë të incidenteve apo kërcënimeve ndaj gazetarëve. Organizatat mediale dhe mekanizmat monitorues vazhdimisht kanë theksuar se një pjesë e rasteve, veçanërisht ato online, mbeten të paraportuara për shkak të mungesës së besimit në mekanizmat institucional, frikës nga pasojat profesionale apo normalizimit të gjuhës kërcënuese dhe presioneve ndaj gazetarëve, veçanërisht në hapësirën digjitale.

Në krahasim me periudhën raportuese të vitit 2026, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se gjatë asaj periudhe Prokuroritë Themelore të Kosovës kishin pranuar gjithsej 16 kallëzime penale për vepra të ndryshme penale ku gazetarët dhe aktivistët kanë qenë në cilësinë e palës së dëmtuar. Në këto raste kanë qenë të përfshirë gjithsej 19 persona. Për 14 persona janë ngritur aktakuza, ndërsa për personat e tjerë të përfshirë, rastet janë zgjidhur përmes hedhjes së kallëzimeve penale.

Pra, krahasuar me vitin 2025, kur nga 16 kallëzime penale shumica rezultuan me ngritje të aktakuzave, të dhënat e vitit 2026 tregojnë nivel më të ulët të progresit procedural gjatë periudhës raportuese.

Për të arritur objektivat e këtij raporti, AGK ka kërkuar të dhëna përmes kërkesës për qasje në dokumente publike edhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mirëpo KGJK është përgjigjur se nuk kanë të dhëna specifike lidhur me rastet që ndërlidhen me gazetarët dhe punonjësit e mediave.

Mungesa e statistikave specifike nga sistemi gjyqësor tregon se rastet që ndërlidhen me gazetarët dhe lirinë e medias ende nuk trajtohen si kategori e veçantë e monitorimit institucional. Kjo vështirëson jo vetëm analizimin e efikasitetit të trajtimit të rasteve, por edhe monitorimin e kohëzgjatjes së procedurave dhe llojit të vendimeve gjyqësore në rastet që prekin sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias.

Në përgjithësi, të dhënat e sistemit prokurorial tregojnë se, ndonëse rastet që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve procedohen në sistemin e drejtësisë, mbetet nevoja për rritjen e efikasitetit institucional, transparencës dhe monitorimit specifik të rasteve që prekin lirinë e medias. Trajtimi efektiv dhe në kohë i rasteve kundër gazetarëve mbetet element thelbësor për forcimin e besimit të gazetarëve në institucionet e drejtësisë dhe parandalimin e mos-sanksionimit të kryerësve.

The period January - May 2026 was characterized by a lack of public reactions from public authorities to attacks and threats against journalists and activists. In a considerable number of cases during this period, public reactions were delayed, weak, or entirely absent, despite the seriousness of the threats and their impact on freedom of expression and journalists' safety.

Monitoring organizations have emphasized that the lack of public reactions from state institutions, including high-level public and political officials, creates a perception of impunity and may contribute to the normalization of attacks and threatening language against journalists and activists. In some cases, institutions have reacted only after public pressure or reactions from local and international media freedom organizations.

In addition to public reactions, international standards require state authorities to take concrete and effective measures for the protection of journalists when there is a real risk to their safety. These obligations derive from the positive obligation of the state to guarantee the free and safe exercise of freedom of expression and the media. The lack of a swift and adequate institutional response in such cases may create a chilling effect, encouraging self-censorship or hesitation by journalists in the exercise of their profession and in reporting on issues of public interest.

Although some serious cases against journalists had occurred during the first months of 2026, including death threats, physical attacks, and organized campaigns of online harassment, there was nevertheless a lack of clear public condemnation from political and state authorities. The cases of serious threats against journalists Kushtrim Sadiku and Lirim Mehmetaj, the physical attack on Burim Pacolli, as well as the organized campaign of online harassment against journalist Ardiana Thaqi-Mehmeti, were not accompanied by public reactions from central authorities.

These cases illustrate the lack of a coordinated and continuous institutional approach to the protection of journalists, particularly in cases involving serious threats or organized campaigns of intimidation.

In addition to public reactions, the lack of institutional transparency regarding the progress of investigations and the handling of cases related to attacks against journalists and activists remains a concern. In many cases, the public and monitoring organizations do not receive sufficient information regarding the measures taken by law enforcement and justice institutions.

In this context, it remains essential that public authorities in Kosovo react in a swift, clear, and coordinated manner to any attack or threat against journalists and activists, by publicly condemning these cases and guaranteeing effective investigation and accountability for the perpetrators.

In many cases, monitoring organizations have noted that a considerable part of threats and inappropriate language against journalists has a political dimension or originates from actors with public and political influence. The lack of a clear reaction and distancing from denigrating language may be perceived as a lack of institutional distancing from such behavior, influencing their normalization.

For this reason, ensuring a clear institutional stance towards attacks and threats against journalists remains essential. Journalists' safety is not only a professional or individual issue but one of the fundamental prerequisites for democratic functioning and the rule of law. A swift, clear, and continuous institutional reaction to any attack against journalists should be treated as a democratic and institutional priority in Kosovo.

8.1 RETORIKA STIGMATIZUESE NDAJ MEDIAVE

Periudha kohore janar - maj 2026 është karakterizuar me mungesë të reagimeve publike nga autoritetet publike ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve dhe aktivistëve. Në një numër të konsiderueshëm rastesh gjatë kësaj periudhe, reagimet publike kanë qenë të vonuara, të zbehta ose kanë munguar plotësisht, pavarësisht seriozitetit të kërcënimeve dhe ndikimit që ato kanë në lirinë e shprehjes dhe sigurinë e gazetarëve.

Organizatave monitoruese kanë theksuar se mungesa e reagimeve publike nga institucionet shtetërore, përfshirë zyrtarët e lartë publik dhe politik, krijon perceptim të mosndëshkueshmërisë dhe mund të kontribuojë në normalizimin e sulmeve dhe gjuhës kërcënuese ndaj gazetarëve dhe aktivistëve. Në disa raste, institucionet kanë reaguar vetëm pas presionit publik ose reagimeve të organizatave vendore dhe ndërkombëtare për lirinë e medias.

Përveç reagimeve publike, standardet ndërkombëtare kërkojnë që autoritetet shtetërore të ndërmarrin masa konkrete dhe efektive për mbrojtjen e gazetarëve kur ekziston rrezik real për sigurinë e tyre. Këto detyrime burojnë nga obligimi pozitiv i shtetit për të garantuar ushtrimin e lirë dhe të sigurt të lirisë së shprehjes dhe të medias. Mungesa e reagimit të shpejtë dhe adekuat institucional në raste të tilla mund të krijojë efekt frikësues (chilling effect), duke nxitur vetëcensurë ose hezitim të gazetarëve në ushtrimin e profesionit të tyre dhe në raportimin për çështje me interes publik. Për rrjedhojë, reagimi i institucioneve duhet të jetë i menjëhershëm, i koordinuar dhe proporcional me nivelin e rrezikut, në mënyrë që të parandalohet përshkallëzimi i kërcënimeve dhe të ruhet një mjedis i sigurt për veprimtarinë mediale.

Ndonëse disa raste serioze kundrejt gazetarëve kishin ndodhur gjatë muajve të parë të vitit 2026, përfshirë kërcënime me jetë, sulme fizike dhe fushata të organizuara të ngacmimit online, megjithatë, mungoi dënimi i qartë publik nga autoritetet politike dhe shtetërore. Rastet e kërcënimeve serioze ndaj gazetarëve Kushtrim Sadiku dhe Lirim Mehmetaj, sulmi fizik ndaj Burim Pacollit, si dhe fushata e organizuar e ngacmimit online ndaj gazetares Ardiana Thaçi-Mehmeti, nuk u shoqëruan me reagime publike nga autoritetet qendrore. Mungesa e reagimeve publike dhe institucionale ndaj rasteve serioze kundër gazetarëve kontribuon drejtpërdrejt në krijimin e perceptimit të mos-ndëshkueshmërisë dhe normalizimin e gjuhës kërcënuese dhe presioneve ndaj mediale.

Këto raste ilustrojnë mungesën e një qasjeje të koordinuar dhe të vazhdueshme institucionale në mbrojtjen e gazetarëve, veçanërisht në rastet që përfshijnë kërcënime serioze apo fushata të organizuara të intimidimit.

Përveç reagimeve publike, shqetësim mbetet edhe mungesa e transparencës institucionale lidhur me ecurinë e hetimeve dhe trajtimin e rasteve që ndërlidhen me sulmet ndaj gazetarëve dhe aktivistëve. Në shumë raste, publiku dhe organizatat monitoruese nuk marrin informacione të mjaftueshme lidhur me masat e ndërmarra nga institucionet e rendit dhe drejtësisë, çka ndikon negativisht në besimin ndaj mekanizmave institucional për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe sigurisë së gazetarëve.

Në këtë kontekst, mbetet e domosdoshme që autoritetet publike në Kosovë të reagojnë në mënyrë të shpejtë, të qartë dhe të koordinuar ndaj çdo sulmi apo kërcënimi kundër gazetarëve dhe aktivistëve, duke dënuar publikisht këto raste dhe duke garantuar hetim efektiv dhe llogaridhënie për autorët. Reagimi institucional i menjëhershëm dhe i vazhdueshëm është thelbësor për krijimin e një mjedisi të sigurt për ushtrimin e lirë të gazetarisë dhe aktivizmit në interes publik.

8.1 RETORIKA STIGMATIZUESE NDAJ MEDIAVE

Gjatë periudhës raportuese, përveç mungesës së reagimeve institucionale ndaj sulmeve kundër gazetarëve, shqetësim serioz kanë paraqitur edhe deklaratat publike stigmatizuese dhe denigruese ndaj mediave dhe gazetarëve nga përfaqësues politik dhe institucional, të cilat organizatat mediale i kanë vlerësuar si faktor që kontribuon në krijimin e një klime armiqësore ndaj lirisë së medias dhe raportimit kritik në Kosovë.

Në këtë kontekst, zyrtarët publik kanë përgjegjësi të shtuar për të shmangur deklaratat që mund të perceptohen si stigmatizuese, denigruese ose nxitëse ndaj gazetarëve dhe mediave. Duke pasur parasysh pozitën e tyre publike dhe ndikimin që ushtrojnë në opinionin publik, deklaratat e tilla mund të ndikojnë negativisht në sigurinë e gazetarëve, të rrisin rrezikun e ekspozimit të tyre ndaj sulmeve dhe kërcënimeve, si dhe të kontribuojnë në krijimin e një ambienti armiqësor ndaj ushtrimit të lirë të profesionit të gazetarisë. Standardet ndërkombëtare theksojnë se autoritetet publike duhet të promovojnë dhe mbrojnë një klimë të favorshme për lirinë e medias dhe debatin publik, duke u përmbajtur nga retorika që mund të minojë besimin në media ose të cenojë sigurinë e gazetarëve.

Një nga rastet veçanërisht shqetësues të evidentuar gjatë kësaj periudhe ishte ai i gazetares Vesa Hoda, e cila pengua fizikisht gjatë ushtrimit të detyrës profesionale nga pjesëtarë të sigurimit të Kryeministrit të Kosovës.

Në këtë drejtim, shqetësuese mbeten edhe deklaratat publike stigmatizuese dhe denigruese ndaj mediave dhe gazetarëve nga përfaqësues politik dhe institucional. Gjatë vitit 2026, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, në një intervistë televizive përdori termin “mercenarë medial” në adresim të mediave dhe gazetarëve, duke pretenduar se ata “shpifin” për përfitime financiare dhe interesa të caktuara politike.

Në të njëjtin kontekst, shqetësuese mbeten edhe rastet kur përfaqësues të partive politike në pushtet kanë përdorur gjuhë akuzuese dhe denigruese ndaj mediave dhe gazetarëve. Në mars të këtij viti, disa zyrtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, përfshirë deputetët dhe zyrtarët Adnan Rustemi, Dejana Mihali dhe Mefail Bajqinovci, kishin shpërndarë deklarata dhe materiale që implikonin gazetarë dhe media në “pagesa me çanta” dhe ndikime të dyshuara financiare. Deklarata të tilla publike konsiderohen veçanërisht problematike kur vijnë nga zyrtarë të partisë në pushtet, pasi ato mund të interpretohen si përpjekje për delegjitimim të mediave kritike dhe raportimit në interes publik.

Këto raste ilustron një trend tejet shqetësues të retorikës stigmatizuese ndaj mediave nga akterë politik dhe institucional, i cili kontribuon në normalizimin e presionit ndaj gazetarisë kritike dhe raportimit në interes publik. Veçanërisht problematike mbetet fakti se deklarata të tilla vijnë nga përfaqësues të partisë në pushtet dhe persona me ndikim të konsiderueshëm publik, të cilët kanë përgjegjësi të shtuar për të kontribuar në krijimin e një ambienti të sigurt dhe demokratik për ushtrimin e lirë të profesionit të gazetarisë.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se ambienti për ushtrimin e profesionit të gazetarisë në Kosovë vazhdon të karakterizohet nga sfida serioze që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve, presionet ndaj mediave dhe klimën për raportim kritik. Rastet e evidentuara gjatë periudhës janar - maj 2026 tregojnë se gazetarët dhe punonjësit e mediave vazhdojnë të përballen me forma të ndryshme të cenimit të sigurisë së tyre, duke filluar nga kërcënimet verbale dhe sulmet fizike, deri te presionet institucionale, fushatat e organizuara të denigrimit dhe sulmet në hapësirën digjitale. Rritja e numrit të rasteve të raportuara gjatë pesë-mujorit të parë të vitit 2026, e cila ka arritur nivelin e tërë vitit paraprak, reflekton vazhdimësinë e problemeve që ndërlidhen me sigurinë e gazetarëve në Kosovë. Natyra e rasteve të evidentuara tregon gjithashtu se kërcënimet ndaj gazetarëve nuk kufizohen më vetëm në terren, por janë zhvendosur gjithnjë e më shumë edhe në hapësirën digjitale dhe në diskursin publik, ku gazetarët përballen me fushata të koordinuara të sulmeve, gjuhë kërcënuese dhe tentativa për delegjitimim publik të punës së tyre profesionale.

Veçanërisht shqetësuese mbetet rritja e kërcënimeve dhe presioneve online ndaj gazetarëve dhe mediave, përfshirë rastet e sulmeve kibernetike, ngacmimeve online dhe gjuhës së urrejtjes. Gratë gazetare dhe gazetarët investigativë vazhdojnë të jenë ndër grupet më të ekspozuara ndaj këtyre formave të presionit. Rastet e evidentuara gjatë kësaj periudhe tregojnë se sulmet shpesh synojnë jo vetëm frikësimin e gazetarëve, por edhe diskreditimin profesional dhe kufizimin e pjesëmarrjes së tyre në debat publik dhe raportim kritik.

Raporti evidenton po ashtu sfida serioze në reagimin institucional ndaj rasteve që prekin sigurinë e gazetarëve. Ndonëse shumica e rasteve të raportuara janë proceduar në sistemin penal, numri i rasteve që vazhdojnë të mbeten në procedurë, mungesa e statistikave specifike nga sistemi gjyqësor dhe mungesa e transparencës lidhur me ecurinë e rasteve vazhdojnë të mbeten shqetësime serioze për organizatat mediale dhe mekanizmat monitorues. Trajtimi jo mjaftueshëm efikas i rasteve që ndërlidhen me gazetarët mund të kontribuojë në krijimin e perceptimit të mos-ndëshkueshmërisë dhe të ndikojë negativisht në besimin e gazetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë.

Shqetësim serioz mbetet edhe mungesa e reagimeve të qarta dhe të vazhdueshme publike nga autoritetet shtetërore ndaj sulmeve dhe kërcënimeve kundër gazetarëve. Në disa raste të evidentuara gjatë kësaj periudhe, reagimet institucionale kanë munguar plotësisht ose kanë ardhur vetëm pas reagimeve të organizatave mediale dhe presionit publik. Përveç kësaj, deklaratat publike stigmatizuese dhe denigruese ndaj mediave nga përfaqësues politik dhe institucional kanë kontribuar në krijimin e një klime të pafavorshme për gazetarinë kritike dhe raportimin në interes publik.

Gjetjet e raportit përputhen në masë të madhe edhe me vlerësimet e organizatave dhe mekanizmave ndërkombëtarë për lirinë e medias, të cilët gjatë viteve të fundit kanë evidentuar përkeqësim të pozitës së Kosovës në raport me lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve. Rënia e Kosovës në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij, si dhe shqetësimet e evidentuara në raportet e Freedom House dhe Komisionit Evropian, reflektojnë probleme të vazhdueshme që ndërlidhen me presionet ndaj mediave, vetëcensurën, mungesën e reagimeve institucionale dhe klimën për raportim kritik në Kosovë.

Siguria e gazetarëve nuk është vetëm çështje individuale apo profesionale, por një nga parakushtet themelore për funksionimin demokratik të shoqërisë dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për informim të lirë dhe të pavarur. Për këtë arsye, mbrojtja efektive e gazetarëve dhe krijimi i një ambienti të sigurt për ushtrimin e profesionit të gazetarisë duhet të trajtohen si prioritet institucional dhe demokratik në Kosovë.

9. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në funksion të përmirësimit të sigurisë së gazetarëve dhe garantimit të lirisë së medias në Kosovë, AGK jep këto rekomandime:

PËR POLICINË E KOSOVËS:

- Të krijohet një pikë kontakti specifike për trajtimin e rasteve të gazetarëve;
- Të zhvillohen protokolle për reagim të shpejtë ndaj kërcënimeve online;
- Të rritet koordinimi me prokuroritë dhe organizatat mediale në trajtimin e rasteve që prekin sigurinë e gazetarëve.
- Të organizohen trajnime të specializuara për zyrtarët policorë lidhur me të drejtat e gazetarëve gjatë ushtrimit të profesionit dhe garantimin e sigurisë së tyre;
- Të organizohen trajnime për zyrtarët policorë lidhur me hetimin e formave të ndryshme të cenimit të sigurisë së gazetarëve, përfshirë kërcënimet, sulmet fizike dhe format e intimidimit, në mënyrë që të sigurohet trajtim profesional dhe efektiv i këtyre rasteve.

PËR KPK-NË DHE PROKURORITË:

- Të caktohen prokurorë kontaktues për rastet që ndërlidhen me lirinë e medias;
- Rastet ndaj gazetarëve të trajtohen me prioritet;
- Të publikohen statistika periodike mbi trajtimin e rasteve.
- Në Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Lëndëve (SMIL) të shtohet komponenta e profesionit për identifikimin e gazetarëve si palë në procedurë, me qëllim të evidentimit dhe monitorimit më efikas të rasteve që prekin lirinë e medias.

PËR KGJK-NË DHE GJYKATAT:

- Të krijohet databazë specifike për rastet ndaj gazetarëve;
- Sulmet ndaj gazetarëve dhe punonjësve të mediave të trajtohen me prioritet;
- Të publikohen raporte periodike.
- Në Sistemin e Menaxhimit Elektronik të Lëndëve të shtohet komponenta e profesionit për identifikimin e gazetarëve si palë në procedurën penale dhe civile, me qëllim të rritjes së transparencës, monitorimit dhe trajtimit të specializuar të rasteve që prekin lirinë e medias.

PËR KUVENDIN E KOSOVËS DHE QEVERINË E KOSOVËS:

- Të monitorohet zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian lidhur me lirinë e medias;
- Të shqyrtohet nevoja për krijimin e mekanizmave ligjor kundër padive SLAPP;
- Të dënojnë publikisht çdo sulm ndaj gazetarëve;
- Të shmangin gjuhën stigmatizuese ndaj mediave.

PËR MEDIAT:

- Të zhvillohen politika të brendshme për mbrojtjen e gazetarëve nga sulmet fizike dhe dhuna digjitale;
- Të sigurohen trajnime për sigurinë fizike dhe digjitale të gazetarëve;
- Të inkurajohet raportimi i çdo veprimi anti-ligjor i ndërmarrë ndaj gazetarëve;
- Të punohet me gazetaret gra për problematizimin e gjuhës polarizuese që mund të shërbejë si justifikim për dhunën.
- Të ofrohet mbështetje ligjore dhe psikologjike për gazetarët e ekspozuar ndaj kërcënimeve dhe sulmeve;
- Të forcohet solidariteti profesional dhe reagimi i koordinuar ndaj rasteve që prekin sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e medias.



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

SIGURIA E GAZETARËVE DHE LIRIA E MEDIAS NË KOSOVË

(Raport monitorues për periudhën janar – maj 2026)